

Rumeli

RUMELİ İSLÂM ARAŞTIRMALARI DERGİSİ

مجلة روم اهل للبحوث الإسلامية | Rumeli Journal of Islamic Studies

ISSN :2564 -7903 Yıl/Year :3 - Sonbahar/Spring 2020 - Sayı / Issue :6



TRAKYA
ÜNİVERSİTELER BİRLİĞİ
İLAHİYAT FAKÜLTELERİ

RUMELİ

İslâm Arařtırmaları Dergisi

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية / Journal of Islamic Studies

Yıl / Year: 3 – Sonbahar / Spring 2020 – Sayı / Issue: 6



ISSN: 2564-7903

Dergimizin Tarandıđı Veritabanı ve İndeksler:



Makale Tercümesi / Article Translation

FAKTORËT SOCIO-PSIKOLOGJIK QË NDIKUAN NË ZHVILLIMIN E RRYMAVE FETARE: RASTI I KOSOVËS

Feim Gashi*

Çev. / Perkth. Avni Lala**

Geliş Tarihi: 24 Ağustos 2020

Kabul Tarihi: 10 Eylül 2020

Abastrakti:

Gjatë gjithë historisë ç'do rrymë, kult apo fe është zhvilluar në rrethana të ndryshimeve radikale shoqërore ose krizash. Me shpërbërjen e Jugosllavisë linden kriza të nryshme andaj shumica e njerëzve u përballën me shumë problem kulturore, fetare dhe politike etj. Kjo shpërbërje përgatiti mjedisin e përshtashëm për përhapjen e shpejtë të lëvizjeve të reja fetare që dolën si reaksion (alternativ) i besimeve fetare tradicionale në republikën e Kosovës. Nga njëra anë vazhduan të japin efekt rrymat fetare me origjinë krishtere dhe të Lindjes së largët, dhe nga ana tjetër ishin rrymat radikale fetare me origjinë nga Lindja e Mesme.

Qellimi kryesor i ketij hulumtimit përbëhet nga faktorët socio-psikologjik që ndikuan në zhvillimin e rrymave fetare në rastin e Kosovës. Me hulumtimin e bërë kemi vërejtur se diskriminimi, shekullarizimi, ekonomia, politika dhe faktori i arsimit kanë ndikuar sidomos në përhapjen e lëvizjeve të reja fetare. Shteti si në ç'do fushë tjetër edhe në këtë fushë ka detyrimet e punimet e tij që duhet t'i realizoj. Siç mund të përmendim përcaktimin e grupeve fetare në baza kushtetuese, ashtu siç është në BE, ku secila lëvizje duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes në përputhje me kushtetutën. Sepse strukturat që nuk u është përcaktuar statusi kushtetues përgatisin një terren të përshtashëm për të dëmtuar pse jo edhe për t'u dëmtuar. Gjithashtu e rëndësishme është autorizimi dhe emërimi i njerëzve kompetentë që kanë mbaruar të gjithë arsimin e duhur të lartë, në këtë mënyrë mund të parandalohen keqkuptimet dhe keqinterpretimet fetare dhe informimin dhe ndihmën fetare shpirtërore për të cilën besimtarët kanë nevojë. Vetëm në këtë mënyrë njerëzit nuk mund orientohen dhe ndihmohen ashtu siç duhen, në të kundërt herët apo vonë orientimi dhe vatja nëpër adresat e gabuara mund të bëhet e pasmangshme.

Fjalët kyçe: Fe, Faktor, Sosjologji, Psikologji, Rrym, Ndikim.

THE SOCIO-PSYCHOLOGICAL FACTORS AFFECTS THE EMERGENCE OF NEW RELIGIOUS TRENDS: THE KOSOVA CASE

Abstract:

Crisis environments and rapid social changes have made significant contributions to the emergence of a new religion, a congregation or a new religious movement throughout history. The crises that emerged with the dissolution of Yugoslavia caused people to face many political, cultural and religious problems. This disintegration paved the way for the rapid spread of new religious movements that emerged as a reaction to traditional religious beliefs in the Republic of Kosovo. While new religious movements of Christian and Far Eastern origin were trying to be effective, on the other hand, religious movements originating from the Middle East started to be influential.

* Dr. Öğrt. Üyesi, Kırklareli Üniversitesi, İlahiyat Fakültesi, feimgashi@klu.edu.tr, Orcid Id: 000-0002-2059-4649.

İntihal: Bu makale "iThenticate" intihal tarama programında taranmış ve intihal içermediği tespit edilmiştir.

Plagiarism: This article has been scanned by iThenticate. No plagiarism detected.

Atif / Citation: Gashi, Feim. "Faktorët Socio-Psikologjik që Ndikuan në Zhvillimin e Rrymave Fetare: Rasti i Kosovës". Rumeli İslâm Araştırmaları Dergisi / 6 (Ekim 2020): 157-174.

** Dr. avni.lala@hotmail.com.

The main purpose of this study is to determine the socio-psychological factors of these trends that emerged in Kosovo. In this study, it has been found out that deprivation, secularization, economic, political and educational factors are at the forefront in the spread of new religious movements. In this regard, as in almost every subject, the state has important responsibilities. Initially, the state of Kosovo should ensure that the legal status of religious and religious groups are determined on a constitutional basis and subject to control accordingly, as in the EU. Because these structures, whose legal status has not been specified, will be in a position to be victimized and victimized. Secondly, it is among the duties of the state to find the authorities and officials who will protect themselves from wrong and show the truth to the people of Kosovo who want to live in full of all the orders and prohibitions of the religion. Because when people cannot find this authority, it is inevitable for them to apply to the wrong addresses.

Keywords: Religion, Factor, Sociology, Psychology, Current, Impact.

YENİ DİNİ AKIMLARIN ORTAYA ÇIKMASINI ETKİLEYEN SOSYO-PSİKOLOJİK FAKTÖRLER (KOSOVA ÖRNEĞİ)

Öz:

Kriz ortamları ve hızlı toplumsal değişimler tarih boyunca yeni bir din, cemaat veya yeni bir dinî akımın ortaya çıkmasında önemli katkılar sağlamıştır. Kriz ortamı olarak görülmesi de Modern dönemde yeni dinî hareketlerin önemli bir ivme kazandığı XX. yüzyıl, tüm dünyada bir toplumsal değişim ve bunalım dönemi olarak karakterize edilmektedir. Başka bir ifadeyle, modern dönem, geleneksel toplum yapısı ve düzeninde çok önemli değişimlerin oluşmasına sebep olmuştur. Modern dönemde yaşanan hızlı değişimler; dünyaya aşırı eğilim, aşırı rasyonalizm, pozitivizm, materyalizm, bir otorite ve inanç boşluğu olgularını da beraberinde getirmiştir. Böylece ortaya çıkan toplumsal anomi ortamında “büyüsü bozulan dünya”da aşırı sekülerleşme sonucu bir kenara itilen geleneksel inançlar ve dinler bu ihtiyaçlara cevap veremeyince ortaya çıkan boşluk, yeni dinî hareketler tarafından doldurulmaya başlanmıştır.

Buna bağlı olarak bizde bu çalışmanın ana konusunu Yugoslavya'nın dağılmasıyla kurulan devletlerden biri olan Kosova Cumhuriyetinde ortaya çıkmış olan yeni dini akımların sosyo-psikolojik faktörleri oluşturmaktadır. Zira Yugoslavya'nın dağılmasıyla birlikte yeni kurulmuş devletlerde insanların çoğu birçok siyasi, kültürel ve dinî problemlerle karşı karşıya kalmıştır. Bu dağılma, geleneksel dinî inançlara tepki olarak ortaya çıkan yeni dinî akımların hızlı bir şekilde yayılmasına ortam hazırlamıştır. Bir taraftan Hıristiyan ve uzak doğu kökenli yeni dinî akımlar etkili olmaya çalışırken, diğer taraftan da Orta Doğu kökenli, daha çok Selefi ve Vehhabi zihniyeti etrafında şekillenen dinî akımlar da etkili olmaya başlamıştır.

Konuyla ilgili yapılan çalışmaların çoğunda olduğu gibi bizim çalışmamızda da geleneksel dini yaklaşımlar ilerleyen ve her bakımdan değişen toplum ile hızlı olarak hareket etmesi zor olmuş ve toplumla arasındaki fark açılınca da bu boşluğu yeni gruplar doldurmaya başlamıştır. Özellikle bazı geleneksel dini inançların gelişen teknolojinin insan hayatına getirdiği yeniliklere ayak uyduramaması bireyin kimliğinde karmaşa yaratmıştır. İnsanlar içine düştükleri bu çıkmazdan ve boşluktan farklı söylemleri olan ve bireye önem veren, toplumda var olduğunu, değerli olduğunu, işe yaradığını hissettiren yeni dinî akımlara yönelmişlerdir.¹ Ayrıca farklı kültürlerin küçülen dünyada birbirleriyle temasları da çoğalmıştır. Karşılıklı bilgi ve kültür alışverişi sırasında toplumlar birbirlerinin kültüründen, din anlayışından veya yeni dinî akımlarından etkilenmişlerdir. Bunun yanı sıra Kosova'nın yaşadığı savaş döneminde (1997-1999) birçok aile mülteci olmuş, ülkelerini istemeyerek terk etmiş ve komşu ülkelere göç ettirilmişlerdir. Göç ettiklerinde yardıma muhtaç olan halk misyonerlerden destek görmüştür ve bu da yeni dini akımlara ilgililerini artırmıştır.

Sonuç olarak diğer konularda olduğu gibi yeni dinî akımlar ile ilgili Kosova Cumhuriyetine düşen iki önemli görevin olduğunu düşünüyoruz. *Birincisi*, Kosova devleti din ve dinî grupların

¹ Sakine Ak, *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birliği Mevlana Yuce Vakfı Orneği* (İzmir: Dokuz Eylül Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yüksek Lisans Tezi, 2008), 15.

AB'nde olduğu gibi, anayasal bir zeminde hukuki statülerinin belirlenmesini ve ona göre denetime tabi tutulmalarını sağlamalıdır. Zira hukuki statüsü belirlenmemiş bu yapılar, mağdur etmeye de mağdur edilmeye de müsait durumda olacaklar. Ayrıca hukuki statünün belli olması her iki tarafın da yararına olacaktır. *İkincisi*, dinin bütün emir ve yasaklarını eksiksiz bir şekilde yaşamak isteyen Kosova halkına, kendilerini yanlıştan koruyacak, doğruyu gösterecek otorite ve yetkilileri bulmak da devletin görevleri arasındadır. Çünkü insanların bu otoriteyi bulamadıkları durumlarda yanlış adreslere müracaat etmeleri kaçınılmazdır. Başka bir ifadeyle, eğer devlet tarafından toplumun bu ihtiyacı karşılanmaz ise farklı misyoner ve sivil kuruluşlar bu ihtiyacı karşılar ve bunun sonucunda da din eğitiminin kontrol altında tutulması imkânsızlaşır.

Anahtar kelimeler: Din, Faktör, Sosyoloji, Psikoloji, Akım, Etki.

Hyrje

Gjatë gjithë historisë çdo rrymë, kult apo fe është zhvilluar në rrethana të ndryshimeve radikale shoqërore ose në rrethana krizash. Edhe pse periudha e modernizmit nuk duket dhe nuk trajtohet si periudhë krize, është qart se rrymat fetare janë zhvilluar duke arritur në kulmin e tyre në shekullin XX. Dhe si rrjedhojë, kjo në të gjithë botën karakterizohet si një periudhë trubullire dhe ndryshimi social, andaj nga ky këndvështrim duhet të theksojmë se rrymat fetare janë produkt i periudhës moderne dhe të kushteve të saj.² Me një shprehje tjetër, shoqëria moderne ka sjellë ndryshime rrënjësore në strukturën dhe në normat e shoqërisë konservatore. Këto ndryshime ishin shkak në zhvillimet dhe ndryshimet rrënjësore tek eksperiencat fetare të shoqërive konservatore. Disa grupe fetare, sekte, komunitete, rryma, lëvizje apo formime fetare që janë emërtuar si (lëvizje të reja fetare) që nga fillimi i shekullit XX, janë shndërruar në një fenomen të rëndësishëm fetar dhe social.³ Megjithatë nuk duhet të harrojmë se shumica e studiuesve të shkencave sociale në periudhat e para i kanë konsideruar si grupime marginale dhe nuk e kanë parë të nevojshme as t'i kenë në objekt të hulumtimeve të tyre. Por, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore këto lëvizje shënojnë një zhvillim të shpejt dhe përhapje të madhe demografike. Kështu që mund të thuhet se përhapja më e shpejt demografike e rrymave fetare kontretizohet pas vitit 1970. Këto rryma, veçanërisht në këtë periudhë, kishin tërhequr edhe vëmendjen e studiuesve të shkencave sociale pasi ata qenë vendimmarrës në politikë. Bashkë me këto ndryshime të shpejta që po ndodhnin në periudhën moderne dolën dhe fenomene si, mungesa e besimit dhe e autoritetit fetar e cila u zëvendësua gradualisht me një prirje ekstreme në botë, racionalizmi ekstrem, pozitivizmi, materializmi etj. Në këto rrethana shoqërore, si rezultat i shekullarizmit ekstrem, fetë dhe besimet tradicionale ishin mënjeluar nga këndvështrimi se “në botë është prishur magjia”. Në këtë mënyrë, nga pamundësia për t’iu përgjigjur nevojave që rridhnin nga shoqëritë komplekse u krijua një boshllëk ku rezultoi që këto rryma fetare me karizmën e tyre të nisnin të mbulonin këtë vakum.⁴ Natyrisht rrymat e reja fetare ishin shfaqur për të përmbushur nevojat dhe kërkesat shpirtërore të shoqërive në rrethana të reja.⁵ Gjithashtu rrymat e reja fetare nga njëra anë mundësonin botëkuptimin dhe sistemin e besimit të ri të ndjekësve të tyre, nga ana tjetër ata hetonin dhe vënin në dyshim duke e sulmuar rendin fetar tradicional dhe vlerat shoqërore.⁶ Duket qartë se këto sulme nganjëherë ishin thjesht verbale, por nganjëherë ato konkretizoheshin edhe në veprime, ku shumica e njerëzve që jetonin në shtetet e sapo krijuara pas shpërbërjes së Jugosllavisë u përballën me shumë problem kulturore, fetare dhe politike etj. Kjo shpërbërje përgatiti mjedisin e përshtatshëm për përhapjen

² Ünver Günay, *Din Sosyolojisi* (İstanbul: İnsan Yayınları, 2005), 492-493.

³ Günay, *Din Sosyolojisi*, 489.

⁴ Günay, *Din Sosyolojisi*, 499.

⁵ Günay, *Din Sosyolojisi*, 490.

⁶ Günay, *Din Sosyolojisi*, 497-498.

e shpejtë të lëvizjeve të reja fetare që dolën si reaksion (alternativ) i besimeve fetare tradicionale. Nga njëra anë vazhduan të japin efekt rrymat fetare me origjinë krishtere dhe të Lindjes së largët, dhe nga ana tjetër ishin rrymat radikale fetare me origjinë nga Lindja e Mesme të mbështjellur nën konceptin selefist dhe vehabist.⁷

Ekzistojnë të dhëna se në mbarë botën rrymat e reja fetare arrijnë deri rreth 5000 sosh. Madje sipas disa sociologëve, lëvizjet e reja fetare në mbarë botën janë rreth 5000 dhe ky numër mund të arrijë edhe deri në 20.000.⁸ Me sa duket ky numër do të rritet në vijim dhe me vazhdimin e rritjes të këtij numëri ashtu siç do të ndikojë në vende të ndryshme të botës, po në atë masë ka për ta prekur edhe shoqërinë e Kosovës. Madje kjo rritje na tregon se kjo çështje duhet të studiohet më tej nga studiuesit e shkencave sociale. Në fakt ajo çfarë mund të thuhet është se, pamarëparasysh qëndrimin tonë kundrejt grupimeve, nga një aspekt përderisa ekziston feja, edhe grupi fetar do të jetë i pranishëm.⁹ Këtu për studiuesit e shkencave sociale e rëndësishme është që të arrijnë në informacione të sakta rreth këtyre rrymave dhe në të njëjtën kohë të identifikojnë qasjet e njerëzve kundrejt këtyre rrymave dhe shkaqet që shtrihen mbrenda këtyre qasjeve.

1. Tema e hulumtimit, problematika, hipotezat dhe metodologjia e punës

Tema kryesore e hulumtimit përbëhet nga faktorët socio-psikologjik që ndikuan në zhvillimin e rrymave fetare në rastin e Kosovës. Me një shprehje tjetër, në këtë hulumtim do të kërkohet përgjigjeja e pyetjes se, çfarë situatë socio-psikologjike shtrihet zhvillimi dhe pëlqimi i këtyre rrymave në Kosovë?“. Ndërsa problemet kryesore të hulumtimit tonë përbëhen nga pyetjet: cilët ishin faktorët kryesorë që ndikuan në zhvillimin e rrymave me origjinë nga Lindja dhe Perendimi pas luftë 1997-1999 në Kosovë dhe pse gjetën përkrahje në popull? Ndërsa hipotezat janë këto: Kur shoqëritë ndodhen në periudha krize, përballë problemeve politike, ekonomike dhe ligjore, njerëzit për të gjetur qetësi hyjnë në kërkime të ndryshme shpirtërore. Në të njëjtën kohë, këto lloj rrymash përhapen në shoqëritë që nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm dhe në ato ku mësimi fetar nuk është i suksesshëm ose i pamjaftueshëm. Në hulumtim janë përdorur dokumente përshkrimi dhe teknikat e vëzhgimit. Ana teorike e hulumtimit është formuar duke u bazuar në referencat përkatëse të literaturës. Është treguar kujdes i veçant që të merret në konsiderat literatura dhe media lokale. Gjithashtu në pjesën e fundit të studimit është përdorur teknika e vëzhgimit, si një teknik kyçe e shkencave sociale.

2. Terminologjia e përdorur

Termi i konvertimit, pra “conversion” që përdoret në gjuhët perëndimore nuk nënkupton vetëm kalimin nga një fe në një tjetër, por njëkohësisht ajo nënkupton edhe kalimin brenda për brenda fesë nga një sekt në një tjetër. Kështu që “conversion” është përjetimi i ndryshimit në çështjen fetare, siç mund të përdoret dhe për një fetar ashtu mund të përdoret dhe për ata që janë larguar nga botëkuptimet fetare. Shprehja lëvizje/rrymë e re fetare për herë të parë ka filluar të përdoret në fillimet e viteve 1970.¹⁰ Arsye pse janë quajtur këto të reja është sepse të gjithë ata janë shfaqur në rrethanat pas Luftës Dytë Botërore, pra janë shfaqur në një kohë të afërt, siç dihet shumica e këtyre lëvizjeve në përgjithësi u shfaqën në vitin 1950 dhe u përhapën masivisht

⁷ İrfan K. Ülger, “Orta Asya’da Radikalizm Tehdidi: Gerçek mi? Efsane mi?”, *II. Uluslararası Sosyal Bilimciler Kongresi* (Bişkek, 2008), 446.

⁸ Ali Köse, *Milenyum Tarikatları/Batı’da Yeni Dini Akımlar* (İstanbul: Truva Yayınları, 2006), 17.

⁹ Cemal Özel, “Dini Grupların Birbirleriyle Olan İlişkilerini Etkileyen Bazı Faktörler: Psikososyal Bir Yaklaşım”, *The Journal of Academic Social Science Studies*, 72 (Sonbahar, 2018), 329-348,

¹⁰ Ali Rafet Özkan, *Kıyamet Tarikatları: Yeni Dini Hareketler* (İstanbul: Kültür Sanat Yayınları, 2006), 13-14.

në vitet 1960 dhe 1970.¹¹ Këto rryma edhe pse janë konsideruar si rryma të reja kurr nuk i kanë shkëputur kontaktet me të shkuarën. Megjithatë ato posedojnë shumë veçori të reja pavarësisht marrëdhënieve me të kaluarën.¹² Në gjuhët perendimore konvertimi që përdoret për të shpjeguar kalimin nga një fe në një tjetër nuk nënkupton konvertimin fetar nga një fe në një tjetër, por thekson dhe anën psikologjike, politike, estetike, mendimet sociale, si dhe ndryshimin, kthimin, largimin apo qëndrimin në besimin fetar.¹³ Nocioni shpreh një ndryshim të plotë dhe kalimin nga një sistem besimi në një tjetër.¹⁴ Ashtu siç u përmend më lart, ky term nuk përdoret vetëm për kalimin nga një fe në një tjetër po gjithashtu ai përdoret edhe për të treguar kalimin nga një bashkësi fetare në një tjetër dhe nga një sekt në një tjetër apo nganjëherë përdoret edhe për kalimin nga një rrymë fetare në një tjetër. Kushtu që edhe në këtë punim, nocionin konvertim do ta përdorim për të shënuar kalimin nga një rrymë fetare në një tjetër. Në turqisht dhe në kultruën islame, konvertimi i fesë shpjegohet si “i udhëzuar” në qoftë se një person pranon Islamin, e nëse del nga feja islame dhe e kundërshton atë, atëherë kjo shprehet me nocionin “irtidat” - braktisje. Ndërsa në gjuhët perendimore, veçanërisht në anglisht interpretohet si konvertim fetar. Shprehja konvertim përcaktohet si mosrespektim i individit ndaj urdhërave të fesë të së cilës ai i përket ose heqja dorë nga urdhërat fetarë, ose për një jobesimtarë do të thotë pranimi i rregullave fetare të shoqërisë që ai i përket duke u kthyer në një ithtar të fesë, njëkohësisht ky term nënkupton dhe braktisjen e një feje dhe kalimin në një fe tjetër.¹⁵ Nëse do të vështrojmë me kujdes literaturën do të arrijmë në konkluzionin se janë përdorur nocione të ndryshme për të përkufizuar lëvizjet e reja fetare. Si përshembull, disa nga këto janë: kult, sekt, grupime të rrezikshme, tarikat, medh’heb dhe fe të reja.

Ata që i hulumtojnë rrymat e reja fetare nga aspekti teologjik kanë përdorur nocionin kult. Në esencën e këtij përdorimi fshihet një nënçmim. Sipas nocionit kult, rrymat e reja fetare ua marrin peng mendjen pjestarëve të tyre, duke i pasur nën kontroll ata. Madje këto rryma janë të devijuara dhe dinake. Në fakt me këtë ligjërim, nënkuptohet se rrymat e lartpërmendura janë besime të çoroditura që nuk përputhen me autoritetin aktual fetar dhe as nuk korrespondojnë me besimin tradicional të shoqërisë.¹⁶ Gjithashtu vihet re se ka përkufizime të ndryshme nga njëra te tjetra të lëvizjeve fetare. Në sociologjinë e fesë, këto lëvizje kategorizohen si fe e re ose fetë reja apo kulte shkatërruese, tarikatet (sektet) e të rinjëve, fetë rinore, organizime psiqike, fe bashkëkohore (New age), lëvizje të reja fetare dhe rryma të reja fetare.¹⁷ Nëse i vështrojmë me kujdes analizat subjektive në lidhje me lëvizjet e reja fetare, ajo çfarë bie në sy është se disa nga përkufizimet janë këto: “një përpjekje për t’i dhënë një kuptim të ri besimeve dhe ritualeve fetare në varësi të rigjenerimit të shenjtërisë”, “këto lëvizje janë më çliruese krahas traditës imponuese dhe u japin mundësinë individeve për të zgjedhur”, “me evolucionin e teknologjisë dhe industrisë, lëvizjet fetare janë një përpjekje për t’iu përgjigjur nevojave të ndryshme dhe diferencimit të individit në aspektin fetar, pa prishur ecencën e saj”, “lëvizjet fetare në

¹¹ Mehmet Ali Kirman, “Yeni Dini Hareketleri Tanımlama Problemi ve Tipolojik Yaklaşımlar”, *Din Bilimleri Akademik Araştırma Dergisi*, III/4 (Samsun, 2003), 6.

¹² Kirman, “Batıda Ortaya Çıkan Yeni Dinî Hareketlerin Karakteristik Özellikleri”, 317.

¹³ Antonie Vergote, *Psychology of Religieuse*, 232; Aktaran, Hüseyin Peker, *Din Psikolojisi* (İstanbul, Çamlıca Yayınları, 2008), 201.

¹⁴ Hüseyin Peker, *Din Değiştirme Psiko-Sosyolojik Etkenler* (Ankara: Ankara Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü Doktora Tezi, 1979), 10.

¹⁵ Ali Köse, *Neden İslam’ı Seçiyorlar: Müslüman Olan İngilizler Üzerine Psiko-Sosyolojik Bir İnceleme* (İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, 2008), 13.

¹⁶ http://www.yenişafak.com.tr/düşünce/Aydoğan_Vatandaş (12.04.2005)

¹⁷ Adem Efe, “Küreselleşme Yeni Dini Hareketler ve İnternet,” *Uluslararası Davraz Kongresi 24-27 Eylül 2009*, (Isparta: Küresel Diyalog, 2009), 3232-3238.

përgjithësi janë grupe të vogla që shkundin autoritetin fetar, kundërshtojnë besimet dhe ritualet e saj dhe prishin harmoninë e shoqërisë konservatore.”¹⁸ Madje rrymat e reja fetare mund të klasifikohen edhe mënyra të reja që reflektojnë emocionet fetare.¹⁹ Këto lëvizje që kohët e fundit janë prezente edhe në Turqi, janë emërtuar me nocione të ndryshme si “lëvizjet\sektet milleniumare”, “tarikate”, “sektet e apokalipsit”, “grupet kulturi”, “mendime dhe grupe fetare”, “fetë bashkëkohore” dhe “rrymat e feve moderne”. Këto lëvizje kryesisht janë formuar nga njerëz modern që refuzojnë kishën dhe gjithashtu refuzojnë disa interpretime të kishës joracionale që kundërshton modelin e shoqërisë moderne, por nga ana tjetër kërkojnë një doktrinë dhe praktikë fetare moderne që do të mbushë hendekun shpirtëror. Lëvizjet e larpërmendura prezantohen dhe me emrin “sektet dhe fetë e të rinjëve” për faktin se ata kryesisht kanë tërhequr vëmendjen e të rinjëve.²⁰

Eshtë interesant fakti se janë po hulumtuesit e shkencave sociale ata që kanë analizuar dhe debatuar historikun e rrymave të reja fetare, të cilat në kohën e fundit janë përhapur masivisht në nivel botëror. Gjithashtu studiuesit e shkencave sociale as që mendonin se ia vlen të studiohen rrymat e reja fetare në fazat e para. Me një shprehje tjetër, studiuesit e shkencave sociale mendonin se bashk me modernizmin, feja do të mbetet si diçka e prapambetur dhe vendin e saj do ta zënë shkencat pozitiviste. Por në fakt ndodhi e kundërta e saj dhe nisi një gjallëri fetare që mund të quhet kthim kah feja.²¹ Kështu, pas vitit 1950, shumë lëvizje të reja fetare u shfaqën si një fenomen global në shoqëritë e industrializuara perëndimore, e cila u pranua si një pikë kthese e rëndësishme në të gjithë botën.²² Në mënyrë të përmbledhur që pas vitit 1950, faktorët si ndryshimet e shpejta shoqërore, trazirat dhe shekullarizimi që u shfaqën në botë, i hapën rrugë ndryshimeve në strukturat socialo-kulturore dhe politike të shoqërive po gjithashtu edhe në botën e emocioneve, mendimeve, besimeve dhe vlerave të individëve. Si rezultat, njerëzit filluan të hynë në kërkime të reja për të përmbushur nevojat e tyre fetare. Për të kënaqur njerëzit që ishin në një kërkim të tillë dhe për të ruajtur besnikërinë e tyre, lëvizjet e reja fetare duke krijuar disa organizata u përpoqën të shndërrohën në një fenomen global. Globalizmi dha kontribut në rritje dhe përhapjen e këtyre grupacioneve. Por gjithashtu edhe lëvizjet e larpërmendura mbajtën ritmin e tij.²³ Pjesa më e madhe e këtyre rrymave të reja u shfaqën në Perëndimin e krishterë dhe veçanërisht në SHBA. Aq më tepër sa që SHBA është shndërruar në një treg i feve. Këto rryma nuk janë të kufizuara vetëm në SHBA, sepse ato janë shfaqur edhe në pjesë të ndryshme të botës. Eshtë vërë re se këto rryma kanë synuar territoret gjeografike që përjetojnë kaos, veçanërisht në fushat e ekonomisë, politikës, arsimit dhe kulturës. Publiku i synuar i lëvizjeve të reja fetare që shfaqen në ambiente të tilla, përgjithësisht përbëhet nga të rinj. Është e mundur të tërhiqen paralele midis shkaqeve që çuan në shfaqjen e lëvizjeve të reja fetare në Perëndim dhe agjentëve që shkaktuan përhapjen e bashkësive fetare (xhemateve) dhe tarikateve/ekteve në botën Islame. Sikurse Perëndimi që dëshmoi shfaqjen e shumë lëvizjeve të reja fetare pas Luftës së Dytë Botërore, edhe shoqëritë Islame kanë dëshmuar shfaqjen e një numri botëkuptimesh fetare dhe struktura sektesh brenda komunitetit të tyre.

¹⁸ Ak, *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birliği Mevlana Yüce Vakfı Örneği*, 14.

¹⁹ Mehmet Ali Kirman, “Batıda Ortaya Çıkan Yeni Dinî Hareketlerin Karakteristik Özellikleri”, *Uluslararası Avrupa Birliği Şurası Tebliğ ve Müzakereleri* (Ankara 2000), 317.

²⁰ Efe, “Küreselleşme Yeni Dini Hareketler ve İnternet”, 4.

²¹ Köse, *Neden İslam'ı Seçiyorlar*, 23-24.

²² İllir Rahimi, *Kosova'da Din Değişirmenin Psiko-Sosyolojik Etkenleri* (Bursa: Uludağ Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yüksek Lisans Tezi, 2013), 1.

²³ Hüsnü Ezber Bodur, “Moonculuk Hareketi ve Türkiye’de Benzer Bir Cemaat Yapılanmasının Sosyolojik Analizi”, *KSÜ. İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 1 (Kahramanmaraş: 2003), 13-39.

Edhe pse Islami dhe Perëndimi në aparencë duket se përfaqësojnë dy botëra krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, mund të themi se njerëzit me arsye të ngjashme janë të prirur të drejtohen drejt kërkimeve të reja. Një nga arsyet që çuan njerëzit në këtë kërkim të ri është pikërisht edhe fakti se botëkuptimet ekzistuese fetare dhe strukturat tradicionale fetare nuk mund t'i ofronin njerëzve një botëkuptim të kënaqshëm fetar. Me fjalë të tjera, mund të thuhet se pavarësisht shekullarizimit të shpejt të shoqërisë, mungesa e institucioneve që mund t'i rezistonin shekullarizimit pati një rol vendimtar.²⁴ Ndërsa sociologët deklaruan se lëvizjet e reja fetare arritën sukses paralelisht me industrializimin dhe urbanizimin në shoqëritë globale.²⁵ Kur analizohet literatura rreth lëvizjeve të reja fetare vihet re se një pjesë e rëndësishme e hulumtimeve janë realizuar në njëzet vjeçarën e fundit të shekullit XX, ndërsa në dekadën e parë të shekullit XXI numëri i këtyre hulumtimeve ka vazhduar të rritet.²⁶ Kur kësaj panorame t'i shtojmë territore gjeografike dhe shoqëri të reja, me plotë bindjen mund të themi se tani e tutje kjo çështje do të jetë objekt hulumtimi edhe për një kohë të gjatë.

3. Faktorët socio-psikologjik

Në rastin tonë konkret faktorët socio-psikologjik ndikuan në rënien e shtetit të Jugosllavisë dhe si rrjedhojë filloi një epokë e re në këtë rajon. Me ardhjen e kësaj epoke u krijuan institucione të huaja, si në sferën ushtarake po ashtu edhe aspektin civil. NATO për të ndaluar luftën në vitin 1999 kreu operacione ajrore për shtatëdhjetë e tetë ditë. Pas kësaj ndërhyrje u arrit marrëveshja duke detyruar forcat serbe të tërhiqeshin nga Kosova. Por, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë i'u besua UNMIK-ut dhe kjo administratë i'u mundësoi shumë shoqatave dhe organizatave joqeveritare të huaja që të krijojnë efektivitetin e tyre në Kosovë. Këto shoqata dhe organizata joqeveritare ishin pionerë për lëvizjet e reja fetare në vitet në vijim. Aq sa sipas raportit të Misionit të KB në Administratën e Kosovës, 71 institucione dhe organizata misionare operonin intensivisht në Kosovë. Shumica e tyre përbëheshin nga grupe misionerësh Protestant të ardhur nga Amerika e Veriut dhe Anglia.²⁷ Madje sipas citimeve të sociologut Ferdi Kamberi, nga viti 1999 e deri tani në Kosovë numëroheshin rreth 9917 organizata joqeveritare.²⁸ Atëherë lind pyetja pse ka kaq shumë grupe misionerësh dhe organizata joqeveritare në Kosovë, kur popullësia e saj nuk arrin as dy milionë? Objektivat e tyre janë për të shëruar plagët e shoqërisë, që ende nuk kanë shpëtuar nga problemet e luftës, apo diçka tjetër? Për më tepër, njerëzit u japin apo jo vëmendje madhore këtyre rrymave?

Ka shumë mendime rreth pjesëmarrjes së njerëzve në lëvizjet e reja fetare. Për shembull, krizat e identitetit dhe personalitetit, veçanërisht krizat në periudhën e adoleshencës dhe konfuzimet mendore, ndryshimet e shpejta kulturore dhe tendencat e kërkimeve për të ndërtuar një identitet të ri në këtë korniz, përbëjnë elementet më bazike për shfaqjen e një personaliteti me gjendje shpirtërore të përshtatshme për të të marrë pjesë në këto rryma. Ka edhe prej atyre që përshtaten në grupe dhe lëvizje të tilla si rezultat i interesave dhe kërkimeve fetare apo

²⁴ Furkan Sancar, "Dini Cemaatlerin Üye Kazanma Stratejileri Beyin Yıkama Olarak Değerlendirilebilir Mi? Kullandıkları Teolojik Argümanlar Üzerinden Eleştirel Bir Okuma", *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, 9/42 (Şubat 2016), 1919.

²⁵ Ahmet Faruk Kılıç, "Din Sosyolojisinde Dini Grup Tipolojileri", *Değerler Eğitimi Dergisi*, 5/13 (2007), 37-58.

²⁶ Süleyman Turan, Yen Dini Hareketlerle İlgili Türkiye'deki ve Batı'daki Literatür, *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, 6/27 (Yaz 2013), 562.

²⁷ <http://www.habervaktim.com/yazar/ilik-savunmasi-turkiyeye-mi-kaldi56659.html#.UNkSAE8c44k.facebook>

²⁸ Ferdi Kamberi, "Afer 10 mijë OJQ në Kosovë", në <https://gazetainfokus.com/afër-10-mijë-ojq-ne-kosove/> (17 Mayıs 2018).

filozofike. Disa psikologë dhe sociologë deklarojnë se përveç atyre që janë të ndjeshëm dhe janë në kërkim të lëvizjeve të tilla, në këto rryma anëtarësohen edhe persona që kanë një tendencë tjetër fetare.²⁹ Edhe sociologu Eileen Barker që njihet me hulumtimet rreth lëvizjeve të reja fetare, gjithashtu thekson se njerëzit që antarësohen në këto rryma i lënë besimet e mëparshme kur vendosin të adoptojnë një besim të ri fetar, duke nxjerr në pah se mjedisi shoqëror dhe kushtet sociale përreth tyre janë shumë të rëndësishme.³⁰ Është e qartë se hulumtimi kërkon analizë shumëdimensionale, duke lindur nevoja për kontributin e shumë disiplinave, siç është psikologjia sociale, psikologjia apo psikologjia e masave etj. Një nga kryeveprat në këtë fushë është konsideruar libri *The True Believer (Besimtari i Vërtet)* i autorit Eric Hoffer, i cili nënvizon këto vërejtje: Fakti që një lëvizje masive (rrymë fetare) që është në zhvillim e sipër arrinë të rekrutojë pjestarë të rinjë dhe i mban ata nënkontroll nuk është nga forca apo vërtetësia e doktrinës që ajo ofron, por është, sepse ajo jep një alternativë për gjithë ata që duan të shpëtojnë nga bota e ankthit, pamundësisë dhe pakuptimësisë. Kjo lëvizje masive nuk përpiqet t'u shpjegojë të shtypurve dhe të zhgënjyerve arsyet e disa fakteve, ose të kurojë vështirësitë që kanë shkaktuar lëndime në jetën e tyre, por përpiqet t'i shërojë ata njerëz duke i shpëtuar nga personaliteti i tyre i papërshtatshëm. Dhe këto rryma e bëjnë këtë kurim duke i rekrutuar ata njerëz nën rendin e një komuniteti të mirëorganizuar dhe shpresëdhënës.³¹ Këto përshkrime të Hofferit ofrojnë disa të dhëna që na ndihmojnë për të kuptuar pjesëmarrjen e njerëzve në lëvizjet e reja fetare. Interesimi i treguar nga qytetarët në këto rryma veçanërisht në Kosovë, përputhet më përshkrimet e Hofferit, ku thotë se këto rryma sjellin një alternative ndryshe për njerëzit që janë të mbytur në pamundësi dhe shqetësime.

Kush janë anëtarët e rrymave të reja fetare? Ose, nga cila kategori e shoqërisë këto rryma mbledhin më shumë ndjekës? Sipas Snow dhe Machalek, në përgjithësi shumica e antarëve janë të rinjt, zakonisht në të njëzetat, ata që i përkasin klasës së mesme, ata që kanë marrë arsim më të lartë se mesatarja e përgjithshme e shoqërisë, dhe shpesh vijnë nga qarqe të shëndosha familjare. Në fakt, këto rezultate tregojnë se anëtarët e lëvizjes së re fetare janë një popullsi shumë e marginalizuar dhe e tjetërsuar në shoqëri, dhe në një moment ata shpjegojnë edhe prirjen e njerëzve drejt një lëvizje të re fetare që nuk është e përhapur.³² Sepse rrymat e reja fetare ofrojnë një strehë për njerëzit që jetojnë në shoqëri, por janë të marginalizuara nga shoqëria. Shkurtimisht, faktorët mjedisorë janë shumë të rëndësishëm në shfaqjen e një lëvizjeje shoqërore dhe në mbledhjen e ndjekësve. Me fjalë të tjera, struktura demografike, ekonomike, politike, gjeografike, fetare dhe kulturore e vendit apo e shoqërisë është bërë absolutisht e ndikueshme për lëvizjet fetare dhe për njerëzit që pëlqejnë këto rryma.³³ Kështu, në këtë studim, nën pesë tituj kryesorë do të identifikohen faktorët që ndikuan në shfaqjen e lëvizjeve të reja fetare në Republikën e Kosovës, përhapjen e tyre dhe prirjen e njerëzve në këto lëvizje, të cilat janë: diskriminimi, shekullarizimi, ekonomia, politika dhe arsimi. Padyshim që tituj të rinj mund të shtohen në këto tematika, por ne do të përpiqemi të vlerësojmë temën në këto tituj.

²⁹ Günay, *Din Sosyolojisi*, 498-499

³⁰ Eileen Barker, "Bringing Them in: Some Observation on Methods of Recruitment Employed by New Religious Movements", *New Religious Movements and the Church*, eds. A.R. Brokway and J.P. Rajashekar (Genev, 1987), 69/79.

³¹ Eric Hoffer, *The True Believer: Kesin İnançlılar*, çev. Erkil Günür (İstanbul: Plato Yayıncılık, 2011), 34.

³² Snow A. David ve Machalek R., "The Sociology of Conversion", *Annual Review Sociology*, X (1984), 181-182.

³³ Vejdî Bilgin, "Yeni Dini Hareketler", *Din Sosyolojisi*, ed. Talip Küçükcan (Eskişehir: Anadolu Üniversitesi, 2013), 202.

3.1. Faktori i diskriminimit

Sipas teorisë së marginalizimit ose përjashtimit; diskriminimet sociale, psikologjike dhe fizike të njerëzve janë faktorët kryesorë për pjesmarrjen në një grup fetarë apo ideologjik. Kur shpërblehen nga grupi, diskriminimi bëhet i durueshëm.³⁴ Sipas kësaj teorie, njerëzit që janë diskriminuar nga pikëpamja ekonomike, shoqërore ose nga një diskriminim ndryshe, implikohen në një numër grupimesh të reja fetare për të kompensuar këto privime.³⁵ Bashkimi në grupin e ri jo vetëm që ofron mbështetje fizike dhe morale për të diskriminuarit, por gjithashtu siguron paqe dhe besim për njerëzit që janë të paaftë dhe me aftësi të kufizuara.³⁶ Madje kur bëhet fjalë për të rinjtë që kanë preferuar lëvizjet fetare, përveç vetmisë së tyre që ka ndikuar në pranimin pa hezitim të doktrinave fetare, mund të thuhet se ata janë siguruar dhe nga frika, shqetësimi dhe ankthi metafizik. Megjithëse këto shqetësime janë të pranishme te çdo individ dhe veçanërisht te të rinjtë dhe adoleshentët janë më intensive, kjo grupmoshë është shndërruar në audiencën e synuar e të gjitha grupeve fetare dhe ideologjike.³⁷

Faktorët që të çojnë në diskriminim janë shumë të ndryshëm. Problemet psikologjike mund t'i konsiderojme si të parët faktor që krijojnë ndjenjën e diskriminimit. Mungesa e fuqisë së personit që e lidhë atë me jetën, duke u përballur me problemin e pakuptimtë; pse ai jeton, mungesa e njerëzve të cilëve mund t'i besojë dhe të ndjejë mbështetjen e tij në çdo kohë (vetminë) konsiderohet si njëri ndër faktorët psikologjikë. Gjithashtu edhe aftësitë e kufizuara janë faktor të rëndësishëm diskriminimi. Njerëzit të cilët kanë një sëmundje ose kanë aftësi të kufizuara fizike shpeshherë i drejtohen pyetjes pse u ndodhi atyre kjo dhe si rrjedhojë kërkojnë mjedise ku mund të gjejnë mbështetje. Përveç kësaj, vihet re se edhe njerëzit e përjashtuar për shkak të së kaluarës së tyre ose zakoneve të dëmshme kanë marrë pjesë në lëvizjet e reja fetare me përkrahje psiko-sociale. Këto lëvizje eliminojnë ndjenjën e diskriminimit dhe i ndihmojnë anëtarët e rinjtë të rimarrin vetëbesimin e tyre duke i vendosur në role dhe përgjegjësi të rëndësishme për personin që ndihet i pavlerë. Për shkak të kësaj ndjenje që fiton në këtë grupacion thuajse individi entuziasmohet aq shumë sa që rilind. Njerëzit që në të kaluarën e tyre janë parë nga shoqëria si të pavlerë, të papërshtatshëm, të paaftë, të pasuksesshëm, të këqij dhe që kanë këto ndjenja deri në këtë gradë menjëherë fitojnë ndjenjën dhe krenarinë e të qenurit mes njerëzve të zgjedhur ose shërbëtorët special (robërit e veçanti) të Zotit.³⁸ Në këtë kontekst mund të themi se grupe të reja fetare në vendet që ata operojnë përpiqen të përdorin të rinjtë që janë të përjashtuar nga vendet e origjinës, që kanë një ndjenjë të dobët të përkatësisë dhe që shpirtërisht kanë tendenca për prirje, duke synuar bashkimin e tyre nën një çati.³⁹ Lëvizjet e reja fetare filluan një praktikë të ngjashme në Kosovë pasi lufta mbaroi me ndërhyrjen e NATO-s në 1999. Frika nga humbja e familjes dhe të afërmëve gjatë luftës ka orientuar njerëzit drejt qendrave ku ata mund të besojnë. Këto qendra në përgjithësi përbëheshin nga organizata të ndryshme joqeveritare dhe lëvizje misionare, që vinin nga vendet e tjera. Dhe këto rryma ua shtrënguan duart njerëzve me besim, duke zgjatur dorën e ndihmës. Si herë të tjera edhe kësaj

³⁴ Ak, *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birliği Mevlana...*, 15.

³⁵ Rahimi, *Kosova'da Din Değiştirme'nin Psiko-Sosyolojik Etkileri*, 26.

³⁶ Günay, *Din Sosyolojisi*, 451.

³⁷ Argyle M., *Dinin Yedi Psikolojik Temeli, Eğitim Hareketleri Dergisi*, çev. Mehmet Dağ, V. XXII/2 (Ankara: 1978), 8; Neda Armaner, *Psikopatolojide İlk Dinî Belirtiler* (Ankara: Demirtaş Yayınları. 1973), 104; Muhammed Kızılgöç, *Yalnızlık Umutsuzluk ve Dindarlık Üzerine Psiko-Sosyal Bir Çalışma* (Ankara: Gece Kitaplığı. 2015), 38.

³⁸ Bilgin, *Yeni Dini Hareketler*, 201.

³⁹ Bukatcha Akimjan Kyzy, "Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençliği Üzerindeki Etkileri ve Din Eğitiminin Rolü", *Gelecek Vizyonlar Dergisi*, 2/4 (2018), 31-39.

here njerëzit që janë të përjashtuar nga mjedisi i tyre për shkak të disa problemeve si ekonomike, kulturore ose psikologjike janë gjithashtu të interesuar për prirje në të tilla. Deklarata (intervista) e mëposhtme e Faton Gashit e dhënë në radion e Kosovës, që ishte detyruar të migronte në kampet e Maqedonisë për shkak të luftës në Kosovë të vitit 1999, është e mjaftueshme sa i përket temës sonë: në periudhën e luftës ishim detyruar familjarisht të migrojmë. Ne pasi migruam në Maqedoni na vendosën në kampe përqendrimi. Por kushtet në kamp ishin të kufizuara, gjë që na shtyu në kërkime të reja. Për të kërkuar ndihmë një ditë shkua të një fondacion që ndodhej jashtë kampit ku u pritëm shumë mirë nga njerëzit që punonin aty. Pas kësaj nganjëherë shkonim atje për të marrë ndihma. Pastaj, përveç gjërave dhe ushqimit, ata na jepnin edhe broshura fetare. Në këtë mënyrë në u njohëm me këto rryma ku disa prej tyre i pëlqyem. Kurse ne nuk kishim dijeni për rryma të tilla më parë.”⁴⁰

3.2. Faktori i shekullarizimit

Dihet se një nga tezat kryesore për shfaqjen e lëvizjeve të reja fetare në Perëndim ishte dhe teoria e shekullarizimit.⁴¹ Si rezultat i ndryshimeve të shpejta që përjetuan shoqërit e industrializuara dhe në epokën e informacionit, distancimi i fesë nga jeta publike ishte e ndjeshme dhe kjo shkaktoi një hendek të vështirë për të mbushur vendin e saj në jetën shoqërore. Njerëzit që kishin humbur shpresat më të rëndësishme si rezultat i kësaj distance nga feja, për t’u lidhur sërish me anën shpirtërore të tyre, mund t’i mbushnin zemrat e tyre me një besim që është më i rehatshëm dhe i më lehtë për ta, pa provuar ndonjë vështirësi në jetën e tyre. Me sa duket, nga njëra anë procesi i shekullarizimit dobësoi veprimtarinë shoqërore të fesë, dhe nga ana tjetër mbollti farat e reaksioneve që do ta sillnin përsëri fenë në rendin e ditës.⁴² Në të vërtetë, sipas ekspertëve që punojnë në këtë fushë, rryma të tilla përhapen më shumë në vendet ku shekullarizimi është i fortë.⁴³ Për shembull, që nga viti 1945 e deri më sot, në Angli janë shfaqur më shumë se katërqind lëvizje të reja fetare. Pra numri i grupeve fetare që punonin në 1985 ishte 183, ku dhe për një million banor i bie 3.2 % lëvizje fetare.⁴⁴ Kjo ndodhë sepse Anglia është një ndër shtetet më të dobëta të besimit tradicional. Njëkohësisht Anglia është një ndër shtetet më të forta në procesit e shekullarizimit. Nuk është për tu habitur që procesi i shekullarizimit që çoi në një përfundim të tillë si në Perëndim po ashtu edhe në Kosovë. Sepse, në procesin e shekullarizimit nga njëra anë ka humbur rëndësia e fesë, nga ana tjetër kanë filluar të shfaqen format e reja të besimit (fetarë).⁴⁵ Për shembull, sipas raportit të Administratës së Misionit të KB pas luftës së vitit 1999 në Kosovë janë formuar 71 institucione misionare. Edhe sociologu Ferdi Kamberi, në intervistën e dhënë për Radio Kosovën nënvizon se në Kosovë janë themeluar afro 9917 organizata joqeveritare dhe disa prej tyre janë aktive intensivisht në vend.⁴⁶

3.3. Faktori ekonomik

Operacioni ajror i NATO-s ndaj Serbisë përfundoi më 10 qershor 1999, dhe kështu lufta në Kosovë pushoi. Por nga ajo kohë dhe deri më tani nuk janë hedhur hapat e duhur në konceptin

⁴⁰ Radio Kosova, 20 Haziran 2005.

⁴¹ Mehmet Ali Kirman, “Yeni Dini Hareketler: Tanım ve Kapsam”, ed. Süleyman Turan- Faruk Sancar, *Yeni Dini Hareketler İçinde* (İstanbul: Açılım Kitap, 2014), 13-26.

⁴² Ali Kirman, *Yeni Dini Hareketler Sosyolojisi* (Ankara: Birleşik Yayınları, 2010), 45.

⁴³ Köse, *Neden İslam’ı Seçiyorlar*, 122.

⁴⁴ Köse, *Neden İslam’ı Seçiyorlar*, 119

⁴⁵ Kirman, *Yeni Dini Hareketler Sosyolojisi*, 45.

⁴⁶ <http://www.habervaktim.com/yazar/ilik-savunmasi-turkiyeye-mi-kaldi56659.html#.UNkSAE8c44k>. facebook

ekonomik. Në një periudhë shumë të shkurtër ka pasur rritje marramendëse të papunësisë në vend dhe kjo ka shkaktuar krizë të thellë ekonomike. Kjo krizë i shtyu njerëzit dhe veçanërisht të rinjtë në kërkime të ndryshme fetare. Për më tepër, probleme të tilla si korrupsioni, varfëria, papunësia dhe pagat e ulëta në vend janë parë si opsione shfrytëzimi nga lëvizjet e reja fetare. Me fjalë më të përmbledhura, për shkak të pabarazisë socio-ekonomike, gjyqësore dhe ligjore në shoqëri, ky grup kërkon të gjej drejtësi dhe të vërtetën në fe.⁴⁷ Pasi mbaroi lufta, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë u bëri thirrje të rinjve duke thënë: Ne shohim që grupet fetare dhe komunitetet e huaja po i mashtrojnë të rinjtë tanë për një pagë të ulët, duke i angazhuar ata në aktivitetet e tyre dhe në këtë mënyrë ata po e degjenerojnë kulturën tonë. Objektivi i këtyre organizatave është i qartë. Ne kemi një rini të shkëlqyer. Sot po vërejmë shenjat e para të (përkeqësimit) dhe të kolapsit moral në Kosovë. Ky përkeqësim arrinë deri në degradimin e shoqërisë tonë. Këto shoqata dhe komunitete fetare operojnë; misionarizmin e tyre, dhe qëllimi i tyre është të ndryshojnë fenë e rinisë sonë. Kështu në këtë mënyrë ata i tregojnë hapurazi qëllimet e tyre duke shpërndarë libra dhe broshura fetare në këmb rrugëve më të frekuentuara të vendit.⁴⁸ Në këtë kontekst Piraku shkroi në revistën Dituria Islame se: “Misionarët udhëtojnë shtëpi për shtëpi me synimin e shpërndarjes së broshurave që të thërrasin në krishterim. Ata i afrohen popullit të Kosovës, veçanërisht atyre që janë të stërlodhur nga papunësia dhe niveli i lartë i jetës, me oferta joshëse siç janë sigurimi i vendeve të punës, bursat dhe nënshtetësia.”⁴⁹ Si rezultat i konvertimit të fesë vihet re se disa nga ata që thanë se ishin të krishterë në Kosovë për shkak të vështirësive financiare kanë marrë një vendim të tillë, ndërsa disa të tjerë e kanë marrë një vendim të tillë me synimin e gjetjes së një vend pune ose për një ndonjë përfitim (privilegj) tjetër.⁵⁰ Për shembull, Fehim Dragusha në një artikull që shkroi në lidhje me këtë temë jep një shembull se si “një vajzë e një familje myslimane që jetonte në fshatin Dobrevë të Fushë Kosovës përjetoi një aksident, për shkak të vështirësive financiare familja e saj kërkoi ndihmë nga institucionet Islame që ndodheshin në Kosovë, por për fat të keq nuk gjeti mbështetje. Ndërsa kisha i ofron familjes së vajzës ndihmën e duhur. Pas kësaj ngjarje ata ndërrojnë fe familjarisht.”⁵¹ Ndërsa një shembull tjetër është edhe situata e Fahri Pajazitit që punonte si shofer në një organizatë jo qeveritare në Kosovë e quajtur ‘Ekipi i Kosovës’. Pajaziti në intervistën e dhënë për kanalin televiziv Klan Kosova, shpjegon se si u pushua nga puna: “Një ditë kur shkova në punën time, teksa u përpoqa të hap derën e njëres prej depove të shoqatës ku punoja vura re se dera nuk u hapë. U habita për situatën e krijuar dhe fillimisht mendova se çelësi i derës ishte prishur. Por për të qenë i sigurt, doja të shkoja te zëvendësdrejtori për të marrë informacion. Zëvendësdrejtori më tha se unë isha i pushuar nga puna. U befasova nga kjo situatë dhe i thashë se doja të dija arsyen pse u pushova nga puna. Ai u përgjigj duke më thënë: Ju hoqën nga puna sepse nuk kishte shumë punë në institucion tonë. Sidoqoftë, nuk isha i kënaqur me përgjigjen që mora dhe pyeta se përse iu ofrua punë një të punësuarit me emrin Jeton Zekaj në të njëjtin vend. Zëvendësdrejtori këtë herë më dha një

⁴⁷ Babajanov, B., *Postsovetskiy Vahhabizm Zanyal Svoyu Nishu v Geopoliticheskom Protivostoyani* (Moskova: Regnum, 2013), 34

⁴⁸ Muhamet Piraku, *Jo Katedrale në emër të shqiptarisë së imagjinuar* (Prishtinë: Shkrola, 2003), 28.

⁴⁹ <http://www.habervaktim.com/yazar/ilik-savunmasi-turkiyeye-mi-kaldi56659.html#.UNkSAE8c44k>. facebook

⁵⁰ Rahimi, *Kosova 'da Din Değiştirmenin Psiko-Sosyolojik Etkenleri*, 72

⁵¹ Feim Dragusha, “Misionaret ne Kosove-(Kosova'da Misyonerlik)”, *Revista Studenti*, Reviste e Studenteve Kosovare ne Brunei, 5/1 (Nentor 2007), 4.

përgjigje më përshtues dhe tha se Jeton Zekaj kishte ndryshuar fenë dhe tashmë do të vazhdojnë të punojnë me të.⁵²

Realiteti i të rinjëve që migrojnë nga zonat rurale në qendrën e qytetit ose jashtë shtetit të tyre, me qëllim që të gjejnë punë pothuajse është prezente në çdo shoqëri të botës. Arsyeja që këta të rinjë janë të gatshëm të punojnë në kushte të vështira në këmbim të pagave të ulëta, pasiguria në vendet e migracionit, si dhe përjashtimi nga shoqëria janë shkaqet kryesore që i kanë çuar ata në prirjen e lëvizjeve të reja fetare.⁵³ Dhe kjo situatë ua ka lehtësuar punën lëvizjeve fetare. Si rezultat, këto lëvizje përkdhelin veçanërisht ata të rinj që vinë nga zona rurale, janë të papunë, me arsim të ulët, të varfër, dhe me fjalë të tjera kanë një kalim të dhimbshëm në një ekonomi konkurruese të tregut dhe kanë një kalim të kufizuar të shtresave në shoqëri.⁵⁴ Ne besojmë se lëvizjet e reja fetare si në vendet e tjera të botës po ashtu edhe në Kosovë arrijnë të tërheqin vëmendjen e njerëzve për shkak të përhapjes së padrejtësisë në shkallë masive në vend dhe më e rëndësishmja është dhe dobësimi i strukturës socio-ekonomike. Sepse vihet re se vetëm në vitin 2018 nga Kosova drejt vendet evropiane migruan 34.500 të rinjë. Shumica e këtyre migracioneve janë të lidhura drejtpërdrejt me shkaqet ekonomike. Në një takim që pata me shokun tim të fëmijërisë Bekim Aliun, i cili emigroi nga Kosova drejtë Zvicërës në 1995, ai më thotë: “Kam emigruar vetëm për shkak të vështirësive të mia ekonomike dhe kur arrita në Zvicër nuk kisha ku të qëndroja, e gjeta veten në zyrat e një shoqate. Fillova të qëndroja në shoqatë dhe pothuajse çdo fundjavë njerëzit vinin dhe bënë disa rituale fetare. Pasi ata largoheshin, unë rregulloja dhe pastroja vendin. Kjo gjë që do t’i bënte ata shumë të lumtur. Atëherë ata filluan të më paguanin dhe kjo më bëri të interesohem për besimin e tyre dhe kështu fillova dhe unë të ndjek ritualet e tyre. Kjo pjesëmarrje (konvertim) i lumturoi ata po njëkohësisht edhe mua. Kjo situatë vazhdoi sot e 25 vjet më parë. Nuk e di mbase jam gabim, por për hirë të vërtetës atje pashë humanizmin e vërtet. Sidoqoftë unë një gjë të tillë nuk e gjeta tek myslimanët, madje para se të emigroja drejtë Zvicërës kisha pak informacion rreth Islamit. Nuk e di, por edhe sot ndihem më i lumtur në këtë besim që gjeta në Zvicër.” Duke u nisur nga përgjigja mund të themi se për shkak të luftës dhe krizës ekonomike në ish-Jugosllavi, që nga viti 1992 si Bekim Aliu, qindra-mijëra kosovarë kanë migruar në vende të ndryshme të Evropës. Dhe ka shumë gjasa të takohen dhe emigrantë dhe ata që jetojnë në Kosovë. Prandaj, edukimi fetar duhet të sigurohet nga institucionet zyrtare në mënyrë korrekte dhe me cilësi të lartë si për njerëzit që jetojnë në Kosovë dhe për ata që migrojnë në vende të ndryshme. Përndryshe, njerëzit të cilët nuk kanë marrë mësimin e mjaftueshëm dhe të duhur fetar është e pamundur që të mos ndikohen nga këto lëvizje të tilla fetare.⁵⁵

3.4. Faktori politik

Grupet fetare ofrojnë një alternativë për masat që kërkojnë mënyra për të shprehur pakënaqësinë e tyre politike. Zemërimi, mosbesimi, tjetërsimi i të rinjëve ndaj shteteve dhe qeverive, ka ndikuar në humbjen e besueshmërisë së tyre në sferat e zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale, dhe kjo situatë ka krijuar vakume të theksuara në dimensionin ideologjik që ka nxitur të rinjë të kërkojnë prirje të ndryshme.⁵⁶ Me qasjet ndaluese, konkurrencat e pandershme, mjedise të pasigurta, zhvillimet dhe ndryshimet ekonomike dhe

⁵² <http://www.mesazhi.com/video/organizata-krishtere-ne-kosove-behu-i-krishter-per-ta-ruajtu-vendine-punes> (Kosova.1.17.2013).

⁵³ Bukatcha, *Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençliği...*, 35.

⁵⁴ Bukatcha, *Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençliği...*, 34.

⁵⁵ Bukatcha, *Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençliği...*, 34

⁵⁶ Bukatcha, *Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençliği...*, 34

shoqërore, njerëz që nuk mund të gjejnë atë që presin në fenë tradicionale dhe me shkëmbimin e shpejtë të informacionit në botë si dhe shumë arsye të tjera kanë përgatitur mjedisin e formimit dhe rritjen e lëvizjeve të reja fetare.⁵⁷ Situata aktuale politike në Republikën e Kosovës nuk e shikon si diçka të rrezikshme formatin individual të ritualeve, siç është namazi, agjërimi dhe haxhi, por është shumë skeptike dhe shqetësuese ndaj funksionit të fesë përta i përketë rolit të saj në formimin e shoqërisë.⁵⁸ Sidoqoftë, kjo qasje gjeti një përgjigje të cilën fusha politike nuk e dëshironte dhe i bëri njerëzit të shohin lëvizjet e reja fetare si një mburojë. Siç deklaroi dhe Sherif Mardin, sa më shumë që shtohet presioni laik ndaj shoqërisë, aq më tepër rritet mundësia e përhapjes së rrymave që motivojnë ngritjen shpirtërore. Kështu që këto struktura janë perceptuar si një strehë për njerëzit që ishin të vetmuar në turma.⁵⁹ Sa më shumë që është ushtruar presioni laik ndaj popullit të Kosovës aq më tepër është krijuar mundësia e përhapjes së rrymave të reja fetare Lindore apo Perëndimore. Përpjekjet e shoqërisë për të përgatitur një mjedis, në të cilin ata mund të jetojnë lirinë e tyre të fesë ashtu siç dëshirojnë, konkretizohet nga ndërhyrjet e lëvizjeve të reja fetare.⁶⁰ Për shembull, ndalimi i vazhdueshëm i veshjes së shamive dhe arsimit fetar në shkollat publike të Kosovës, hapi rrugën që njerëzit të drejtohen te kurset e trajnimit të përgatitura nga grupe radikale.

3.5. Faktori i arsimit

Është interesante dhe vlen të përmendet se si shkak i vështirësive ekonomike në vend, në fushën e arsimit, rrymat e reja fetare ofrojnë bursa apo mundësi akomodimi posaçërisht për studentët universitar. Madje rrymat fetare perëndimore i joshin të rinjtë, duke i ofruar atyre arsim dhe mundësi punësimi jashtë vendit. Me fjalë të tjera, të rinjtë që përballen me probleme ekonomike apo të tjerë që duan të vazhdojnë arsimin e tyre jashtë vendit, janë të interesuar për këto rryma, dhe pastaj disa prej tyre i adoptojnë vlerat e këtyre rrymave. Një pikë më e rëndësishme në lidhje me faktorin e arsimit janë edhe pamjaftueshmërit në këtë fushë. Ndër arsyet kryesore janë edhe dobësimi i institucioneve arsimore, ulja e ndikueshmërisë së tyre, organizimi jo i mjaftueshëm i aktiviteteve që rrisin ndërgjegjësimin e studentëve kundër grupeve radikale fetare në shkolla dhe mangësia e stafit cilësorë dhe të specializuarë. Grupet fetare që përfitojnë nga besimi dhe përvoja e pamjaftueshme e të rinjëve, mund të ngulisin lehtësisht qëllimet dhe interesat e tyre tek të rinjtë. Arsimi aktual në shkolla nuk është i mjaftueshëm për zhvillimin e aftësive e të rinjëve për të menduar, interpretuar dhe analizuar në mënyrë kritike. Të rinjtë që janë shkolluar në një institucion të tillë arsimor pritet që t'i shohin strukturat fetare si e vetmja zgjidhje për të kapërcyer problemet në shoqëri si korrupsioni, konkurrenca e pandërshme, varfëria etj. Ky rezultat ua lehtëson punën grupeve fetare që të tërheqin të rinjtë drejt doktrinave të tyre.⁶¹ Gjithashtu edhe mungesa e arsimit fetar në shkolla është me ndikim në këtë çështje. Sepse, në lidhje me këtë temë në temën time të magistraturës kam studiuar rininë e Kosovës në vitin 2008. Të rinjëve që ishin objekt studimi, iu shtrova pyetjen; A jeni dakord me mësimin e fesë në shkollat publike në vendin tonë?; dhe në përgjigjen

⁵⁷ Ak, *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birliği Mevlana...*, 15.

⁵⁸ Richard Tapper, *Çağdaş Türkiye'de İslam*, çev. Özlem Arıkan (İstanbul: Sarmal Yayınevi, 1993), 12.

⁵⁹ Orhan Türkdoğan, "Batı ve Türk Toplumunda Yeni Dini Hareketler", ed. M. Çağatay Özdemir, *İslam'ın Bugünkü Meseleleri İçinde* (Ankara: Türk Yurdu Yayınları, 2008), 49.

⁶⁰ Ak, *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birliği Mevlana...*, 15.

⁶¹ Bukatcha, *Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençliği...*, 34

që ata më dhanë është vërejtur se pjesa dërmuese e të rinjëve (93.8% e të intervistuarëve) pajtohen me futjen e kurrikulës fetare në shkollat publike.⁶²

Njohuria e dobët fetare e të rinjëve kosovarë është shkaku kryesor që ata të ndikohen thellë nga lëvizjet e reja fetare. Në këtë kontekst ne mendojmë se ky problem mund të tejkalohet vetëm duke siguruar një informacion të shëndosh rreth fesë. Sepse mungesa e mundësisë për t'u informuar saktësisht rreth fesë, në shoqëri krijoi një mjedis të përshtatshëm për përhapjen e disa mendimeve të pabaza. Kjo situatë nuk është shumë më ndryshe nga realiteti i një personi që ka rënë në kthetrat e një sëmundje të pakurueshme, por duke thënë më ndihmoni, më shpetoni bie në rrjetin e mjekëve të rremë që realisht janë tregtarë shpresëdhënës.⁶³ Njëri nga intelektualët e Kosovës, Fetih Mehdiu shpreh pikëpamjet e tij mbi këtë temë duke thënë: Unë mendoj se edukimi fetar duhet të jetë i detyrueshëm. Sepse në këtë mënyrë shteti do të jetë në gjendje të kontrollojë të gjithë sistemin. Për më tepër, arsimiti fetar duhet të jetë në shkollë. Sepse feja nuk është e pavlefshme sa që të lihet në dorën sindikatave dhe organizatave joqeveritare. Çdo gjë që është kapital i shoqërisë duhet të organizohet dhe kontrollohet nga shteti. Për hirë të së vërtetës sindikatat dhe organizatat joqeveritare nuk janë aq përgjegjëse për shoqërinë sa shteti".⁶⁴ Është i habitshëm realiteti që autoritetet e shumë institucioneve bashkiake marrin vendime shpeshherë të fshehta dhe nganjëherë të hapura në favor të disa organizatave fetare të huaja. Si për shembull, askush nuk e di qëllimin e disa shkollave private të hapura në Kosovë. Mund të themi se qëllimi kryesor i disa prej këtyre shkollave nuk është të informojmë rininë; madje mendojmë se ato përhapin propagandën e disa lëvizjeve fetare. Me fjalë të tjera, qëllimi kryesor i këtyre shkollave të tilla është t'i hapin rrugën rrymës së tyre fetare në shoqëri.⁶⁵ Akoma sot në Kosovë, lëvizjet e reja fetare ofrojnë kurse falas për të mësuar anglisht dhe kompjuter në qendra apo zyrat e tyre. Ky proces fillon me kurset dhe mund të shkojë deri në antarësimin e kursantëve në lëvizjet e reja fetare apo ndryshimin e fesë. Edhe pse një kurs i gjuhës së huaj kur është falas tingëllon mire në vesh, në të vërtetë vërehet se qëllimi i tyre është ndryshe. Mund të themi se qëllimi i tyre është të diktojnë kulturën e tyre, ligjet e tyre, ekonomitë e tyre dhe më e rëndësishmja vlerat e tyre të besimit. Kështu që, këto organizata që kanë një përvojë të pasur në misionarizëm dhe mbështetje financiare, hapin kurse kompjuteri dhe anglishtes, organizojnë eskursionë në qytete të ndryshme dhe ofrojnë bursa studimi jashtë vendit.⁶⁶

Ashtu siç u theksua dhe më sipër, të rinjtë kosovarë që janë përballur me probleme të ndryshme si ekonomike, destabilizimi politik, drejtësia e korrupsionit dhe mundësitë e kufizuara të edukimit janë joshur nga kushte dhe ofertat e rrymave të reja fetare. Nëse shteti nuk ofron kushte të besueshme dhe të qëndrueshme për të ardhmen e popullit, njerëzit do të përpiqen të hyjnë nga dyert që i hapen nga të tjerët. Në vija të përmbledhura, shteti është përgjegjës për të siguruar zgjidhje për të gjitha problemet në të gjitha fushat, si në sistemin e drejtësisë, po ashtu edhe në fushën e fesë, ekonomisë, arsimit dhe politikës e tij.

⁶² Feim Gashi, "Kosova Cumhuriyetinde Yaşayan Gençlerin Dini Yönelimleri", *Balkan Araştırmaları Dergisi*, 1/1 (2010), 85.

⁶³ İbrahim Sarmış, *Teorik ve Pratik Açidan Tasavvuf ve İslam* (İstanbul: Yöneliş Yayınları, 1995), 237.

⁶⁴ Fetih Mehdiu, *Edukata Fetare Pararoj e Sovranitetit te Kosoves*, <http://www.mesazhi.com/mendime/edukata-fetare-pararoje-e-sovranitetit-te-kosoves> (5 Eylül 2011).

⁶⁵ Arianit Sllamniku, *Konvertimi i Brezave Apo Investim Publiko Privat*, 1-3; www.2online.com (16 Kasım 2012)

⁶⁶ Mbi Kur'anin, "Leter Apologjetike e Shkruar Nga Joseph Smith", ed. Ajni Sinani (Prishtina: 2001), *Balkan Gelecek Tasavvuru-Balkan Sempozyumu*, 197.

4. Përfundimi

Si rezultat mund të thuhet se sot jetojmë në një botë shumëngjyrëshe dhe me ndryshime të mëdha globale. Ky ndryshim qoftë në shkencë, në teknologji, në ekonomi, në politik, në arsim dhe në fe, po ndikon në çdo drejtim të jetës.⁶⁷ Po ashtu edhe rrymat e reja fetare po tregojnë tendencë rritjesh në rrethanat e ndryshimit të shpejt.⁶⁸ Fetë tradicionale e kanë të vështirë të lëvizin me hapa të shpejtë në shoqëritë që po zhvillohen dhe dita ditës po ndryshon nga çdo këndvështrim. Dhe si rrjedhojë është krijuar një distancim mes fesë dhe shoqërisë dhe këtë distancë po e mbushin grupet e reja fetare. Veçanërisht rëndësia që i jep feja tradicionale individit është e pamjaftueshme, sepse feja nuk arrinë dot të përputhet me inovacionet që i ka sjellë teknologjia në jetën e njeriut, e kjo ka krijuar komplikime në identitetin individual njerëzor. Njerëzit për të dal nga rruga pa krye dhe për të mbushur këtë vakum shpirtëror janë orientuar nga doktrina të ndryshme dhe rryma të ndryshme fetare, të cilat i japin rëndësi individit dhe e bëjnë atë të ndihet se është dikushi dhe se është i nevojshëm për shoqërinë.⁶⁹ Në një botë ku janë zvogëluar kulturat e ndryshme është shtuar kontakti me njëra tjetrën. Shoqëritë gjatë shkëmbimit të informacionit dhe kulturës të ndërsjellë, nganjëherë pa qenë të vetëdijshëm dhe nganjëherë të vetëdijshëm filluan gjithashtu të marrin edhe kulturën dhe konceptin e fesë së njëri-tjetrit. Teksa shoqëritë imponojnë kulturën e tyre ndaj shoqërisë rivale, elementët e kulturës së shoqërisë rivale përhapen te individët e shoqërisë imponuese. Këto shkëmbime të ndërsjellta kulturore kanë qenë dhe arsyeja kryesore në zhvillimin dhe formimin e lëvizjeve të reja fetare.⁷⁰ Duhet të themi në mënyrë të përmbledhur se gjatë periudhës së luftës në Kosovë (1997-1999), shumë familje u shndërruan në statusin e refugjatit, u larguan nga vendet e tyre me padëshirë dhe u detyruan të migrojnë në Shqipëri dhe Maqedoninë fqinje. Kur migruan në këto vende, njerëzit në nevojë morën mbështetje nga misionarët. Pas një periudhe të shkurtër, misionarët arritën të fitojnë zëmren e popullit mërgimtar. Kështu që ata filluan t'i mësojnë njëërëzeve fenë e tyre dhe ky ishte dhe qëllimi kryesorë i tyre.⁷¹ Në këtë mënyrë njerëzit që ishin nevojtarë nga njëra anë merrnin ndihmen e ofruar e nga ana tjetër ishin auditor të aktiviteve dhe doktrinave të misionerëve. Me një shprehje tjetër rrymat e reja fetare duke përfituar nga situata të vështira që ndodhej shoqëria u përpoqën të gjejnë simpatizant për doktrinën e tyre.

Si rezultat, ne mendojmë se si në çështjet e tjera, edhe në ata që lidhen me lëvizjet e reja fetare, Republika e Kosovës në bashkëpunim me komitetet/bashkësitë fetare mund të veprojnë më efektive në këtë fushë. Sepse në të kundërt strukturat dhe aktivitetet jotransparente shkaktajnë gjithmonë probleme. Në këtë këndvështrim mund të themi se me një bashkëpunim të thillë do u ofrohet mundësia e nevojitur shoqërisë dhe rinisë. Si rezultat me një arsim fetarë të kontrolluar do të parandalohen edhe keqkuptimet e keqinterpretimet. Mendojmë se kjo është elementare për një të ardhme më të shëndetshme.

⁶⁷ Özkan, *Yeni Din Görünümlü Hareketlerin Ortaya Çıkış Sebepleri*, 5.

⁶⁸ Beckford, *New Religious Movement and Rapid Social Change* (London: Sage/ Unesco, 1986), 11-15, Aktaran; Ali Kirman, "Batıda Ortaya Çıkan Yeni Dini Hareketlerin Bazı Özellikleri ve Toplumsal Tabanları", *Dini Araştırmalar*, 2/4 (Mayıs Ağustos, 1999), 227.

⁶⁹ Ak, *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birliği Mevlana...*, 15.

⁷⁰ <http://www.ewtn.com/library/New Religious Movements> (05.05.2005)

⁷¹ Rahimi, *Kosova'da Din Değiştirmenin Psiko-Sosyolojik Etkenleri*, 75

Literatura/References

- M., Argyle. *Dinin Yedi Psikolojik Temel*, çev. Mehmet Dağ, Eğitim Hareketleri Dergisi, XXII/2, Ankara, 1978.
- Ak, Sakine. *Yeni Dini Akımlar Bağlamında Dünya Kardeşlik Birlięi Mevlana Yüce Vakfı Örneęi*, İzmir: Dokuz Eylül Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yüksek Lisans Tezi, 2008.
- Armaner, Neda. *Psikopatolojide İlk Dinî Belirtiler*, Ankara: Demirtaş Yayınları, 1973.
- B., Babajanov. *Postsovetkiy Vahhabizm Zanyal Svoyu Nishu Geopolitiches- kom Protivostoyanii*, Moskova: Regnum, 2013.
- Barker, Eileen. "Bringing Them in: Some Observation on Methods of Recruitment Employed by New Religious Movements", *New Religious Movements and the Church*, ed. A. R. Brokëay and J.P. Rajashekar, Genev: 1987, 69-79.
- Beckford, *New Religious Movement and Rapid Social Change*, London: Sage/Unesco, 1986.
- Bilgin, Vejdî. "Yeni Dini Hareketler", *Din Sosyolojisi*, ed. Talip Küçükcan, Eskişehir: Anadolu Üniversitesi, 2013.
- Büyükkara, Mehmet Ali. "Dini Grup Yapılarında Dine İlişkin Muhtemel Anlama ve Temsil Sorunları", *Usûl*, 7/7, 2007, 107-136.
- Coşkun, Ali. "Din ve Kimlik", *Marmara Üniversitesi İlâhiyat Fakültesi Dergisi*, 24/1, 2003, 5-23.
- David A. Snow, - R. Machalek, "The Sociology of Conversion", *Annual Review Sociology*, X, 1984.
- Dragusha, Feim. Misionaret ne Kosove-(Kosova'da Misyonerlik), *Revista Studenti*, Reviste e Studenteve Kosovare ne Brunei, 5/, 2007.
- Efe, Adem. "Küreselleşme Yeni Dini Hareketler ve İnternet," *Uluslararası Davraz Kongresi* 24-27 Eylül 2009, Isparta: Küresel Diyalog, 2009, 3232-3238.
- Gashi, Feim. Kosova Cumhuriyetinde Yaşayan Gençlerin Dini Yönelimleri, *Balkan Arařtırmaları Dergisi*, 1/1, 2010.
- Sarmış, İbrahim. *Teorik ve Pratik Açıdan Tasavvuf ve İslam*, İstanbul: Yöneliş Yayınları, 1995.
- Hoffer, Eric. *The True Believer: Kesin İnançlılar*, .çev. Erkil Günur, İstanbul: Plato Yayıncılık, 2011.
- Peker, Hüseyin. *Din Deęiştirme Psiko-Sosyolojik Etkenler*, Ankara: Ankara Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstütüsü, Doktora Tezi, 1979.
- Peker, Hüseyin. *Din Psikolojisi*, İstanbul: Çamlıca Yayınları, 2008.
- Bodur, Hüsnü Ezber. "Moonculuk Hareketi ve Türkiye'de Benzer Bir Cemaat Yapılanmasının Sosyolojik Analizi", *KSÜ. İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 1, Kahramanmaraş, 2003.
- Kamberi, Ferdi. *Afer 10 mijë OJQ në Kosovë*, <https://gazetainfokus.com /afer- 10-mije-ojq-ne-Kosove/> 17 Mayıs 2018.
- Kirman, Mehmet Ali. "Yeni Dini Hareketleri Tanımlama Problemi ve Tipolojik Yaklaşımlar", *Din Bilimleri Akademik Arařtırma Dergisi*, III/4, Samsun: 2003.

- Kirman, Mehmet Ali. Yeni Dini Hareketler: Tanım ve Kapsam, ed. Süleyman Turan- Faruk Sancar, *Yeni Dini Hareketler İçinde*; İstanbul: Açılım Kitap, 2014, 13-26.
- Kirman, Ali. “Batıda Ortaya Çıkan Yeni Dini Hareketlerin Bazı Özellikleri ve Toplumsal Tabanları”, *Dini Arařtırmalar*, Mayıs Ağustos, 1999, 2/4, 227.
- Kirman, Mehmet Ali. “Batıda Ortaya Çıkan Yeni Dinî Hareketlerin Karakteristik Özellikleri”, *Uluslararası Avrupa Birlięi Şurası Teblię ve Müzakereleri*, Ankara, 2000.
- Kılıç, Ahmet Fruk. “Din Sosyolojisinde Dini Grup Tipolojileri”, *Deęerler Eęitimi Dergisi*, 5/13, 37-58.
- Kızılgeçit, Muhammed. *Yalnızlık Umutsuzluk ve Dindarlık Üzerine Psiko-Sosyal Bir Çalıřma*, Ankara: Gece Kitaplığı. 2015.
- Köse, Ali. *Din Deęiřtirmenin Psiko-Sosyolojik Nedenleri, Türkiye’de Misyonerlik Faaliyetleri*, İstanbul: 2004.
- Köse, Ali. *Milenyum Tarikatları Batı’da Yeni Dini Akımlar*, Truva Yayınları, İstanbul: 2006.
- Köse, Ali. *Neden İslam’ı Seçiyorlar: Müslüman Olan İngilizler Üzerine Psiko-Sosyolojik Bir İnceleme*, Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, İstanbul: 2008.
- Kyzy, Bukatcha Akimjan. “Yeni Dini Akımların Orta Asya Gençlięi Üzerindeki Etkileri ve Din Eęitiminin Rolü”, *Gelecek Vizyonlar Dergisi*, 2/4, 2018, 31-39.
- Mehdiu, Fetih. *Edukata Fetare Pararoj e Sovranitetit te Kosoves*, <http://ëëë.mesazhi.com/mendime/edukata-fetare-pararoje-esovranite tit-te-Kosoves>, 5 Eylül 2011.
- Özel, Cemal. “Dini Grupların Birbirleriyle Olan İliřkilerini Etkileyen Bazı Faktör- ler: Psikososyal Bir Yaklaşım”, *The Journal of Academic Social Science Studies*, 72, Sonbahar III, 2018, 329-348.
- Özel, Cemal. “Seküler Zihin, Devlet ve Dini Gruplar: Seküler Kesimin Dini Grup Algısı Üzerine Bir Arařtırma”, *Toplum Bilimleri Dergisi*, 8/16, 2014, 7-27.
- Özkan, Ali Rafet. *Kıyamet Tarikatları: Yeni Dini Hareketler*, Kültür Sanat Yayınları, 2006.
- Piraku, Muhamet. *Dituria İslame*, 63, Prishtina: 1994.
- Rahimi, İilir. *Kosova’da Din Deęiřtirmenin Psiko-Sosyolojik Etkenleri*, Bursa, Uludaę Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yüksek Lisans Tezi, 2013.
- Sancar, Furkan. “Dini Cemaatlerin Üye Kazanma Stratejileri Beyin Yıkama Ola- rak Deęerlendirilebilir Mi? Kullandıkları Teolojik Argümanlar Üzerinden Eleřtirel Bir Okuma”, *Uluslararası Sosyal Arařtırmalar Dergisi*, 9/42, Şubat, 2016.
- Sarmış, İbrahim. *Teorik ve Pratik Açından Tasavvuf ve İslam*, İstanbul: Yöneliş Yayınları, 1995.
- Sinani, Ajni. “Mbi Kur’anin, Leter Apologjetike e Shkruar Nga Joseph Smith”, Prishtina Yayınları, *Balkan Gelecek Tasavvuru-Balkan Sempozyumu*, 2001.
- Sllamniku, Arianit. *Konvertimi i Brezave Apo Investim Publiko Privat*, ëëë.2on- line.com (16 Kasım 2012).
- Tapper, Richard, *Çaędař Türkiye’de İslam* (çev. Özlem Arıkan), İstanbul: Sarmal Yayınevi, 1993.

- Turan. Süleyman. “Yeni Dini Hareketlerle İlgili Türkiye’deki Ve Batı’daki Literatür”, *Uluslararası Sosyal Arařtırmalar Dergisi*, 6/27, 2013.
- Türkdoğan, Orhan. “Batı ve Türk Toplumunda Yeni Dini Hareketler”, ed. M. Çağatay Özdemir, *İslam’ın Bugünkü Meseleleri İçinde*, Ankara: Türk Yurdu Yayınları, 2008.
- Ülger, İrfan Kaya. “Orta Asya’da Radikalizm Tehdidi: Gerçek mi? Efsane mi?”, *II. Uluslararası Sosyal Bilimciler Kongresi*, Bişkek, 2008.
- Günay, Ünver. *Din Sosyolojisi*, İstanbul: İnsan Yayınları, 6. Baskı, 2005.
- Zavalsız, Y. Sinan. “Din Değiştiriminin Psiko-Sosyal Kodları”, *Çukurova Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi*, 12/2, 2012,185-200.
- Zuckerman, Phil. *Din Sosyolojisine Giriş*, çev. İ. Çapçioğlu - H. Aydınalp, Ankara: Birleşik Kitabevi, 2006.
- <http://www.mesazhi.com/video/organizata-krishtere-ne-Kosove-behu> i krishter per ta ruajtu vendin epunes, (Kosova. 17 Ocak 2013).
- http://fejaeventete.com/ifv/index.php/tereja/analiza/index.php?option=com_content&view=article&id=495:ndarja-e-selefive-shkaqet-dhe-metodatepermiresimit&catid=14:analiza&itemid=213<http://ëëë.eëtn.com/library/> New Religious Movements, (5 Mayıs 2005)
- <http://www.yenişafak.com.tr/düşünce/> Aydoğan Vatandaş (12 Nisan 2005)
- <http://www.habervaktim.com/yazar/ilik-savunmasi-turkiyeye-mikaladi56659.html#.UNk> SAE 8c44k.